



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

GJYKATA E SHKALLËS SË PARË E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM VLORË

DEKLARATË E TRUPËS GJYQËSORE E GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM VLORË

Trupa gjyqësore e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, shpreh dhimbjen e thellë për ngjarjen e rëndë që i mori jetën gjyqtarit të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm , z. Astrit Kalaja.

Ky akt i rëndë kriminal, përbën një sulm jo vetëm kundër gjyqtarit, por kundër sistemit të drejtësisë dhe sigurisë juridike në vend. Ai vë në pah rrezikun me të cilin përballen gjyqtarët gjatë ushtrimit të detyrës, duke cënuar autoritetin dhe pavarësinë e pushtetit gjyqësor .

Trupa gjyqësore rithekson domosdoshmërinë e garantimit të kushteve të sigurisë për çdo gjyqtar, si dhe nevojën e respektimit të figurës së tij në shoqëri.

Në një shoqëri demokratike, shteti ka detyrimin ligjor dhe moral për të mbrojtur jetën dhe punën e çdo gjyqtari, sepse vetëm në këtë mënyrë drejtësia mund të përmbush misionin e saj.

Në këto momente të dhimbshme, Trupa Gjyqësore e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë i shpreh ngushëllimet më të sinqerta familjes së të ndjerit, miqve dhe kolegëve të gjyqtarit Astrit Kalaja për këtë humbje të thellë.

Institucioni ynë angazhohet të bashkëpunojë ngushtë me organet kompetente për të garantuar sigurinë fizike të gjyqtarëve, administratës gjyqësore dhe të gjithë përdoruesve të gjykatës.